

# Programi i Iniciativës Balli

Hyrje

## Kapitulli I

### Drejtimi Politik

Iniciativa Balli bën pjesë në spektrin politik të djathtë, gjithashtu jemi parti konzervative sepse respektojm dhe kultivojm traditat kombëtare shqiptare dhe traditat e normat morale dhe etike të banorëve të Kosovës.

Iniciativa Balli veprimin politik e orienton sipas këtij program në disa prioritete, zhvillimin ekonomik, arsimin, shëndetësinë, bashkëpunimin me shtetet euroatlantike sidomos me shtetin e Shqipërisë, SHBA-së, Gjermanisë, Austrisë, Izraelit, dhe me shtete të tjera perendimore që kanë qvndrim miqësorë ndaj Kosovës dhe respektojnë integritetin teritorial të saj.

IB mbështet sistemin pluralist demokrat duke u angazhuar që ta avansoj me tej. IB angazhohet për ekonomi të tregut, për veprimtarit me rëndësi të posaqme shtetërore si Energjetika, telekomunikacioni dhe hekurudhat, ti kontrolloj shteti 100%. Jemi kundër liberalizimit dhe privatizimit të këtyre sektoreve.

Respektojmë çdo ide dhe alternativë për përparim ekonomik politik dhe shoqëror.

## Kapitulli II

### Zhvillimi ekonomik

Per zhvillim ekonomik IB mendon se duhet themelohet Banka për Zhvillim me seli ne Prishtinë dhe shtatë degët e saj ne shtat qytetet më të mëdha te Kosovës ciç janë: Prishtinë, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Gjilan. Kjo bankë do të financonte ndërmarrjet e mesme dhe te vogla me kamata 3% deri 6% vjetore dhe me grejs periudh prej 3 vitesh.

## Kapitulli III

### Zhvillimi i bujqësisë

Kosova ka jashtezakonisht kushte të mira për zhvillim të bujqësisë.

IB mendon se bujqësia mund të zhvillohet nëse 20% e buxhetit të Kosovës të jepet për zhvillim të bujqësisë. Njëkohësisht duhet të formohet një fond për shkollim të kuadrove të bujqësisë (agronom) në shtetet me bujqësi të zhvilluar, bujqësia ka ndikim të madh edhe politika tatimore, ne angazhohemi që tatimet për bujqësi të jenë minimale.

## **Kapitulli IV**

### **Energjetika**

IB angazhohet që sektori i energjetikës të jetë 100% në kontrollë të shtetit ( termoelektranat, politika e çmimeve të energjisë deri ne 30 megavat do të lejoheshin të prodhojnë dhe të ja shesin energjinë shtetit i cili do të distribuonte më tej.

Politikat energjetike do ti formonte shteti dhe do ti aprovonte Kuvendi.

IB angazhohet që prodhimi i energjisë së pastër nga era, uji, dhe dielli ne Kosovë deri ne vitin 2030 duhet te jetë 80%.

Tregu i energjisë nuk duhet te liberalizohet deri sa Kosova të anëtarësohet ne BE.

## **Kapitulli V**

### **Stimulimi**

Sipas IB disa sektor të ekonomisë duhet të stimulohen nga shteti dhe të aktivizohen veprimtaria e tyre si xehtaria, transporti, turizmi, përpunimi i lendeve te para dhe prodhimi per ushtrinë e Kosovës (prodhimi i armeve).

## **Kapitulli VI**

### **Arsimi**

IB angazhohet që arsimi fillor, i mesem dhe i lartë të jenë pa pagesë.

Angazhohemi të formojm nje fond që të shkollojm kuadrat deficitare në shtetet e zhvilluara perendimore për lami të caktuara si informatik, shëndetësi, mbrojtje, shkenca ekzakte, bujqësi etj.

Angazhohemi që në shtate qendrat më të mëdha të Kosovës të hapen shkolla speciale për nxënës të talentuar për shkenca ekzakte.

Shkollat dhe fakultetet private do të reduktonin në minimum – sepse funksionin e arsimit shteti duhet ta mbikqyre dhe mos te lejoj profiterët e ndryshëm të përfitojnë nga kjo lami.



## **Kapitulli VII**

### **Shëndetësia**

IB angazhohet që shëndetësia për banorët e Kosovës duhet të jetë pa pagesë.

Duhet që shërbimet të jenë në nivel të lartë.

Rrjetin e spitaleve të shtrijm në secilin qytet të Kosovës.

Punëtorët e shëndetësisë që punojnë në sektorin shtetëror mos të lejojmë të punojnë në sektorin privat.

Spitalet private mos të lejojmë në afërsi deri në 10 kilometra nga spitalet shtetërore.

Të shkollojmë sa më tepër kuadra të specializuara në shtetet e zhvilluara që pastaj të shërbejnë në Kosovë.

## **Kapitulli VIII**

### **Politika e jashtme**

IB angazhohet që shoqëria e jonë dhe shteti 100% të orjentohej nga bota perendimore nga pakti NATO dhe BE. Gjithashtu angazhohemi të mbajmë marrëdhënie të mira me shtetet që na kanë pranuar dhe na respektojnë integritetin territorial.

Angazhohemi edhe për politike bashkepunimi me shtetet fqinjë që kanë qëndrim miqësor ndaj Kosovës.

## **Kapitulli IX**

### **Sistemi politik**

IB përkrah sistemin pluralist demokratik të instaluar në Kosovë.

Angazhohemi që të bëjmë përmirësime në sistemin politik. Qëndrimi ynë është se qeverin duhet ta formojnë partia apo koalicioni që merr më shumë vota në zgjedhje. Kosova të ndahet në paku në 7 njësi zgjedhore të hiqen vendet e rezervuara në Kuvend për minoritetet, të hiqet shkalla zgjedhore 5% për hyrje në Kuvend, të kthehet sikur në vitet 2001-2004 me 1% të votave 1 delegat të mund të hyjë në Kuvend me 1% të votave të votuesve që kanë dalë në votime.

Personat të cilët kanë kryer vepra penale apo janë nën hetime mos të lejohen të marrin pjesë në zgjedhje.

Të përmirësohet legjislatura për veprimtari ekonomike, të ashpërsohet kodi penal i Kosovës, të ashpërsohet ligji dhe aprovimi i tij për konfiskimin e pasurisë të fituar në menyrë të paligjshme.

Të vihen kode morale dhe etike për vlerat shoqërore.

## **Kapitulli X**

### **Sporti dhe kultura**

IB angazhohet që të përmirësohet ligji mbi sponzorizimin e sportit, që subjektet ekonomike të lirohen nga tatimi aq sa investojnë në sport.

Shteti më tepër të rrit investimet në sport.

Sportistët kulminant të financoj shteti dhe të ju japë privilegje ekzistenciale (pension nacional, roga, banesë për rezultatet e arritura në skenën ërkombëtare).

Në kulturë IB angazhohet për ruajtjen e traditave që na identifikojnë si Komb.

Angazhohemi që të ndërtohen 7 Teatro të rinjë në 7 Qytetet më të mëdha të Kosovës.

Që në Gjakovë dhe Prishtinë të ndërtohen sallat për Oper dhe Filharmoni.

## **Kapitulli XI**

### **Barazia gjinore**

IB angazhohet që grua ja gjithkund të jetë e përfaqësuar 50% në qeveri në vende të punës sidomos në ato shtetërore, në vende udhëheqëse në ushtri të Kosovës dhe në Polici, gjithashtu angazhohemi që të ketë sa më shumë rini në të gjitha veprimtarit.

IB nuk i ndanë gjinitë nëpër forume apo rini sepse konsideron të gjithë të barabartë.

## **Kapitulli XII**

### **Te drejta e njeriut**

Te drejtat e njeriut në shtetin e Kosovës janë rregulluar me Kushtetut dhe me ligj por IB angazhohet që aty ku ka hapësirë për ti avansuar këto të drejta të ndërhyjmë dhe ti avansojmë ato.

Dispozita përfundimtare

IB konsideron se ky program nuk është metafizik, mund të ndryshohet sipas sygjërimeve nga antarësia, apo ndryshimit të ligjeve të Kosovës apo ndryshimit në skenën politike e regjionale apo botërore.

Prill 2021

---

Kryetari

---